# DËSHMI ARKIVI

Factcheck.al · arkiv i pandryshueshëm i mediave shqiptare

**A-424472**
VERSIONI 1

**Ky dokument nuk është prova.** Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

## ARTIKULLI

| | |
|---|---|
| TITULLI | VIDEO/ Në samit me "ujë me vete"! Frika nga helmimi? Presidenti i Azerbajxhanit befason në Bishek, batuta e Pezeshkian: E solle për veten, jo për ne! |
| ADRESA | `https://javanews.al/video-ne-samit-me-uje-me-vete-frika-nga-helmimi-presidenti-i-azerbajxhanit-befason-ne-bishek-batuta-e-pezeshkian-e-solle-per-veten-jo-per-ne/` |
| BURIMI | javanews.al |
| GJENDJA | online |

## KOHA

| | |
|---|---|
| KAPUR NGA NE | 7 shtator 2026, 05:52:25 UTC<br>*Dritarja jonë e pasigurisë: ± 600 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.* |
| DEKLARUAR NGA PORTALI | 2 shtator 2026, 07:28:22 UTC<br>*Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.* |

## HASH-ET · SHA-256

| | |
|---|---|
| PËRMBAJTJA | `67e3de42bd834dc090dd9a675abc38fff76e660d8f116091671365c22b8ed4fc` |
| TEKSTI | `c613f67b65d8ad0cbbf593b567a3cdda7484f10eaaf4d6a76523bd208fd54a53` |
| PAMJA | `18b58c1499b7013709afdb11979eb9895868f615f9be8dacfd5ca74789950097` |

## ZINXHIRI I PROVËS

| | |
|---|---|
| KJO HYRJE | `b0fafa4d5f2ff58ca66b3e42e829035b773c76d5de6562f1b106caa6ff0a094c` |
| E MËPARSHMJA | – |
| RRËNJA MERKLE | `56abbcbaf3b6cd60bdbc3dd20a55296f33672a0dccf17da1de9439540995f565` |
| ANKORUAR | Polygon PoS · bllok 47341833 |
| TRANSAKSIONI | `0xfa77f07e2f53de402e8ca20db239603d7c035a8bccb6de46bbdffdc40f05ed08` |
| IPFS | `QmfNk1ye5WS7ucha3Jomt6DPkEqYuUKCcqZVTzefi5XPd5` |

### SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahaso hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

`https://scan.stamles.eu/verify/b0fafa4d5f2ff58ca66b3e42e829035b773c76d5de6562f1b106caa6ff0a094c`

## PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

# VIDEO/ Në samit me "ujë me vete"! Frika nga helmimi? Presidenti i Azerbajxhanit befason në Bishek, batuta e Pezeshkian: E solle për veten, jo për ne!

A. Q — 02/09/2026 09:28



Shperndaj ne Facebook Shperndaj ne Twitter

Një moment i pazakontë dhe plot humor është regjistruar gjatë Samitit të Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait në Bishkek të Kirgistanit, ku presidenti i Azerbajxhanit, Ilham Aliyev, dhe homologu i tij iranian, Masoud Pezeshkian, thyen për pak çaste formalitetin e takimit diplomatik.

Në pamjet e publikuara nga samiti, Aliyev i drejtohet Pezeshkianit për ujin mineral të vendosur në tavolinë nga organizatorët. Presidenti azerbajxhanas i sugjeron homologut iranian të mos pijë ujin gjeorgjian dhe i propozon në vend të tij një shishe me ujin "Istisu", të cilin e kishte sjellë nga Azerbajxhani.

Pezeshkiani e priti me buzëqeshje propozimin e Aliyevit dhe iu përgjigj me humor:

*"E solle për vete, jo për ne!"*

Batuta shkaktoi të qeshura mes personave të pranishëm. Aliyev vijoi me gjestin simbolik dhe i shërbeu ujë "Istisu" presidentit iranian, përpara se të mbushte edhe gotën e tij. Momenti mori vëmendje edhe për shkak të marrëdhënieve mes dy vendeve dhe prejardhjes së Pezeshkianit. Presidenti iranian ka origjinë azerbajxhanase, duke e bërë takimin me Aliyevin një moment me interes të veçantë në kuadër të kontakteve dypalëshe.

Takimi u zhvillua në kuadër të Samitit të Organizatës së Bashkëpunimit të Shangait, ku liderë të vendeve anëtare u mblodhën për të diskutuar çështje rajonale dhe ndërkombëtare.

Megjithëse takimet e nivelit të lartë zhvillohen zakonisht nën një protokoll të rreptë, shkëmbimi i shkurtër mes Aliyevit dhe Pezeshkianit solli një moment të rrallë informal, që tërhoqi vëmendjen në rrjetet sociale.

TË FUNDIT

Bad Bunny siguron Emmy-n e parë, spektakli i Super Bowl shpërblehet me 7 çmime
SEPTEMBER 6, 2026

Alarm në Pukë, vatër e re zjarri në Tërbun pas djegies së 3 mijë hektarëve
SEPTEMBER 6, 2026

Katalogu politik i revolucionit permanent
SEPTEMBER 6, 2026

Vizita e Berishës në SHBA, salla ku mbajti fjalimin shfaqet thuajse bosh (VIDEO)
SEPTEMBER 6, 2026

Zjarri në Himarë, Tavo: Po punojmë për normalizimin e situatës pas flakëve, vijon evidentimi i dëmeve
SEPTEMBER 6, 2026

Më në fund kontroll real i çmimeve?
SEPTEMBER 6, 2026

"Gozhdën e fundit në arkivolin e Ramës", militanti i Berishës në SHBA ndjek retorikën e kryedemokratit (VIDEO)
SEPTEMBER 6, 2026

VIDEO/ Zjarr pas Kodrës së Krastës në Elbasan, rrezikohen dy banesa
SEPTEMBER 6, 2026

"Gënjeshtër totale"/ SHBA mohon pretendimin e Iranit për sulmin ndaj dronit në Hormuz
SEPTEMBER 6, 2026

"Tërmet" politik në Gjermani! AfD triumfon bindshëm në zgjedhjet rajonale në


Saksoni-Anhalt

SEPTEMBER 6, 2026

## Leave a Reply

**Comment** *

**Name**

**POST COMMENT**

Adresa: Rruga “Mihal Popi”, Pallatet 1 Maji, Shkalla 26, Apartamenti 5, Tiranë
Email: javanews.al@gmail.com

© 2025 **JAVA NEWS** - Të drejtat mbi përmbajtjen mbrohen sipas etikës profesionale dhe ligjeve të Republikës së Shqipërisë.

WP2Social Auto Publish Powered By : XYZScripts.com

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.